REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.tac/Br.str. 358
Date/Datum 10. 11. 2026

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE

MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 29.06.2026, në ora 10:00h, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Laureat Gojnovci, Dardane Sogojeva Shala dhe Ali Ismaili.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis dhe Adriatik Zeqiri - Drejtor për Arsim.

Të tjerë: Lindita Dervisholli Prebreza - Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 25.05.2026.
2. Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029.
3. Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026.
4. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese.
5. Propozim për shpalljen e titullit "Qytetar nderi" i Komunës së Fushë – Kosovës për vitin 2026.
6. Propozim për shpalljen e titullit "Qytetar nderi post mortum", i Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2026.
7. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për taksa komunale.
8. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.
9. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës.
10. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për organizmin e bashkëpunimit të Komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
11. Propozim për shqyrtim dhe dhëniën e ndihmës financiare për shërim shëndetësorë për palën Safet Selimi.
12. Propozim për plotësimin e vendimit në përfshirjen e drejtorit të Inspektoriatit të Komunës së Fushë Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029.
13. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, po e hapim zyrtarisht mbledhjen, po filloj me leximin e pikave të rendit të ditës dhe hapi diskutimin.

Rrahim Sogojeva: Përshëndetje kolegë, ne pajtohemi me rendin e ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar drejtor, në parim ne jemi dakort për shqyrtim të pikave të propozuara, por ndryshimet e dokumenteve strategjike nuk bëhen me vendime.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, sa i përket pikave pajtohemi unë e kam një propozim shtesë për shqyrtimin dhe dhënien e ndihmës financiare për shërim shëndetësorë për palën Safet Selimi, i cili vuan nga një sëmundje e kushtueshme dhe është veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pika lidhur me Spitalin Hospice, thuhet se duhet të harmonizohet me dokumentat e planifikimit hapësinorë, me miratimin e Planit Zhvillimor Komunal, mos e vendosni këtë komitet në lajthitje. Pastaj për propozimin e znj. Dardane Sogojeva, mund të trajtohet, por duhet ta kemi një standard, të vendosim për raste të tilla me kritere, që vijnë nga profesionistët e fushës, jo kështu sipas rasteve 'ad hoc'. Të evidentohet në procesverbal lëshimi i mbledhjes pas mospajtimeve që kanë ndodhur në mbledhje, ku z. Laureat Gojnovci e ka lëshuar mbledhjen, meqë Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis, më ka ofenduar mua dhe përfaqësuesit e opozitës në komitet, kjo qasje është e pa justifikushme dhe nuk duhet të përsëritet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kërkesa për shqyrtimin e ndihmës financiare për shërim shëndetësorë për palën Safet Selimi, i cili vuan nga një sëmundje e kushtueshme dhe është veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mendimi im është se nuk duhet të hapim këtë portë, në mandatin e kaluar, ju e dini se pas rastit të parë të vendosur nga Kuvendi i Komunës për lejimin e mjeteve financiare për shërim dhe trajtim shëndetësorë, numri i rasteve ka shkuar në gjashtë, andaj ju lus që të keni mirëkuptim, sa i përket këtyre rasteve të tilla, që janë të ndieshme. Unë e kam edhe një propozim më shumë të natyrës teknik, për plotësimin e vendimit për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, edhe me një anëtarë z. Durim Hajra - Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit.

Dardane Sogojeva Shala: Nga Komisioni për shëndetësi ky rast është përkrahur me vetëm 200.00€, andaj kërkoi që ky rast të trajtohet dhe shqyrtohet në mbledhjen e Kuvendit të Komunës. Pas sqarimeveë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, theksoi se tani po e qesim në votim 'Propozim për shqyrtim e kërkesës për dhënien e ndihmës financiare për shërim shëndetësorë për palën Safet Selimi'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimoitet të votave vendoset për shqyrtim në mbledhjen e sotme të Komitetit për Politikë dhe Financa 'Propozimi për shqyrtim e kërkesës për dhënien e ndihmës financiare për shërim shëndetësorë për palën Safet Selimi'.

Tani e qesim në votim 'Propozimin për plotësimin e vendimit në përfshirjen e Drejtorit të Inspektoriatit të Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029'.

U votua me: tre vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj që hyn për shqyrtim në rendin e ditës me shumicë të votive 'Propozimi për plotësimin e vendimit në përfshirjen e Drejtorit të

Inspektoriatit të Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029'.
Tani e qesim në votim për shqyrtim rendin e ditës me votimet e cekura më lartë.
U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përdori votën e dyfishtë dhe konstatoj që aprovohet rendi i ditës me dy pika shtesë të cekura dhe aprovuara më lartë.

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 25.05.2026.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim për vërejtjet apo sugjerimet tuaja 'Ekstraktin e Procesverbalit të mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e mbajtur me datën 25.05.2026'. Hap diskutimin.
Rrahim Sogojeva: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovimin 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 25.05.2026'.
Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, janë dy arsye pse nuk mund ta votojmë këtë ekstrakt të procesverbalit. E para, sepse po shkelet Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës, po ashtu ka në disa raste ndryshim të pjesëshëm të diskutimeve tona dhe zbutje të diskutimit apo veprimeve sikur pambuk të anëtarëve të Ekzekutivit të Komunës.
Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Mendoj që është shkelur Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës, nuk po bëhen audio-incizimet, andaj ne jemi kundër.
Ali Ismaili: Unë kam vërejtje për këtë ekstrakt të procesverbalit, shumë pjesë më keni nxjerrë nga tema, shumë pjesë e keni zbukuruar e shumë pjesë nuk jam përshkruar fare. Kërkoj të merret parasysh vërejtja ime te pjesa e diskutimit, të përshkruhet ngjarja ku është lëshuar mbledhja pas mospajtimeve që kanë ndodhur.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e qesim në votim për aprovim 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 25.05.2026', me përmirësimet dhe vërejtjet e cekura për kosntatim nga anëtari z. Ali Ismaili.
U votua me: katër vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj se aprovohet 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 25.05.2026', me përmirësimin dhe vërejtjet e cekura për kosntatim nga anëtari z. Ali Ismaili.

Pika e dytë (2) - Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029', ftoj Drejtorin për Buxhet dhe Financa të na paraqet përmbajtjen e buxhetit.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Përshëndetje për të gjithë, do të bëjë shpalosjen e kornizës afatmesme buxhetore, të cilen ju e keni pranuar, planifikimi i buxhetit për vitet 2027-2029, ka filluar në muajin shkurt, ne i kemi dorëzuar të gjitha kërkesat tona për kategoritë ekonomike. Me datën 15 Maj, ne kemi pranuar Qarkoren e Parë Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ku në bazë të kësaj Qarkore e kemi hartuar Qarkoren e Brendshme Buxhetore të cilën u'a kemi shpërndarë drejtorëve të komunës, të shkollave, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, e tjera. Buxheti për vitin 2027 është 29,400,000.00€, kemi rritje të buxhetit prej 9,65%, kjo rritje ka ndodhur te granti i përgjithshëm me 1,193,000.00€, te granti i arsimit me 580,000.00€, te granti i shëndetësisë me 300,000.00€ dhe të hyrat vetanake janë rritur në 510,000.00€. Ky buxhet krijohet nga të hyrat vetanake në komunën tonë kryesisht nga: tatimi në pronë, lejet ndërtimore, mjedisore e tjera, ne si komunë jemi në vendin e shtatë për grumbullmin e të hyrave vetanake në nivel vendi. Tabela tjetër është: planifikimi i buxhetit për vitin 2027, nëpër kategori ekonomike, kemi stafin, paga dhe mëditje, mallëra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione, transfere dhe investime kapitale. Investimet kapitale financohen prej dy burimeve: granteve dhe të hyrave vetanake, i kemi 48 projekte, 11 projekte janë në vazhdimësi, të gjitha projektet i keni para jush, ne si organizatë buxhetore kemi planifikuar t'i mbajmë 3 dëgjime publike për planifikim te buxhetit 2027-2029, ky është buxhet fillestar, gjatë dëgjimeve buxhetore investimet kapitale mund të ndryshojnë.

Rrahim Sogojeva: Tani lidhur me kornizën afatmesme buxhetore për vitet 2027-2029, të cilën ne e përkrahim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Laureat Gojnovci: Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029, është e njëjtë në përmbajtje me vitet e kaluara, me ndryshime shumë të vogla, është përgatitur nga personi i njëjtë. Krahasuar me premtimet e dhëna nga Kryetari i Komunës në fushatën zgjedhore, ato nuk janë të përfshira në buxhet, as 50% e tyre madje nuk janë të përfsira, as në projeksionet buxhetore për vitet 2028 dhe 2029. Për mbeturina keni realizuar një kontratë me negocim, me një tender prej një million euro për blerjen e kamionëve. Po ashtu i keni rritur shpenzimet operative në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Më shumë lidhur me buxhetin e komunës për vitin 2027, ne do të flasim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, por ne nuk mund ta përkrahim një buxhet të tillë, që nuk pasqyron dhe garanton projekte kapitale në dobi të interesit publik të qytetarëve, duke mos vendosur në buxhet, projektet e premtuara nga Kryetari i Komunës dhe qeverisja e Lëvizjes Vetëvendosje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Projektet kapitale të premtuara, ne do t'i realizojmë bashkë brenda mandatit tonë zgjedhor.

Ali Ismaili: Tani aspektet përmbajtësore dhe statistikore të numrave në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029, u sqaruan në vija të trasha nga Drejtori për Buxhet dhe Financa, ku janë planifikuar gjithsej 37 projekte kapitale të reja, ku mungon projekti për varreza në fshatin Miradi e Epërme, të cilin ju e keni kërkuar sikur edhe e dini, nuk e keni pranuar diskutimin public ta mbajtur në Xhami, kërkojmë që të punoni për zgjidhjen e këtij problem tani nga ana e juaj. Çështja e lokacionit për varreza, është shumë më urgjente në qytetin e Fushë-Kosovës, që duhet të veprohet shpejtë për gjetjen e zgjidhjes. Projektet kapitale të vendosura në buxhet nuk kanë ndonjë

ndryshim esencial, ju rikujtoi se koha kalon shumë shpejtë dhe përfundon mandati, andaj punët e mira duhet të fillojnë tani.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Këtu në buxhet njëmbëdhjetë (11), projekte kapitale janë vazhdimësi, që kanë filluar të të realizohen tek infrastruktura janë tetë (8) ura, ku përdoret termi riparim, ndërsa 37 projekte kapitale janë të reja dhe janë vendosur si prioritare për zhvillim nga Drejtoritë e Komunës, ndërsa për vitet 2028 dhe 2029, kërkojmë nga të gjithë ju, edhe asambleistët e rinjë, që t'i kuptoni si projeksione buxhetore, të cilat mund të ndërrohen në vitin 2027, kur përgatitet buxheti tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas diskutimeve dhe sqarimeve të tjera, e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029'.

U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komitetit për Politikë dhe Financa, kalon me përdorimin e votës së dyfishtë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029', më këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029'.

Pika e tretë (3) - Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026' materialin e keni para vetës, e hapi diskutimin.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Propozimi për ridestinimin e mjeteve financiare prej: 15,000.00€, ka të bëjë me mjetet financiare nga ketegoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve, tek Infrastruktura Publike, meqë kjo pjesë e mjeteve financiare nuk është pranuar të bartet në buxhet për shpenzim nga Ministria e Financave, andaj duhet ta ridestinojmë për shpenzime operative te shërbimet publike, për pagesën e faturave të borxheve të komunës nga viti i kaluar të bartura në këtë vitë.

Rrahim Sogojeva: Në emër të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, pajtohem që 'Propozimi për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026', të procedohet për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Laureat Gojnovci: Ju në të kaluarën na keni kritikuar neve për ridestinim të buxhetit, tani po e bëni të njëjtën procedurë, vetëm me një dallim shtesë, disa herë për të njëjtën punë, po veproni. Pyetja ime është a jeni në këtë rast brenda kufijëve ligjor që e lejojnë bartjen e buxhetit të pa shpenzuar, për shpenzim në vitin e ardhshëm, pa ndonjë propozim shtesë tuajin.

Ali Ismaili: Ju e keni mbushur kodin të kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, edhe pse e keni ditur se kjo punë nuk lejohet me bartje të buxhetit të pa shpenzuar në vitin paraprakë, pse po veproni kështu 'ad hoc', me provë kur kjo punë ju e dini se është e ndaluar. Pse nuk po i bartni këto mjete financiare të pa shpenzuara, për rregullimin e kushteve të asambleistëve të Kuvendit të Komunës, por po vazhdoni njësoi edhe pas gjashtë muajve në qeverisje, pa asnjë ndryshim esencial.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve theksoi, me qenë se nuk kemi diskutime tjera e qesim në votim 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026'.

U votua me: tre vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për ridestinimin e mjeteve financiare nga bartja e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026'.

Pika e katërt (4) - Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumente planifikuese

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumente planifikuese' diskutimin për këtë pikë e kemi pasur në mbledhjen e kaluar, nuk ka ndryshuar asgjë, nëse nuk ka diskutime po e qesim në votim propozimin.

Laureat Gojnovci: Këtu nuk është propozuesi për të na dhënë sqarime, pse duhet të aprovohet propozimi në fjalë

U votua me: tre vota 'për', një voët 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumente planifikuese', më këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit 'Hospica', me zotimin e Drejtorisë së Planifikimit Urban për përfshirjen e saj, në dokumentet e planifikimit hapësinorë të Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e pestë (5) - Propozim për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shpalljen e titullit 'Qytetar Nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026', po e hapim diskutimin. Me qenë se

nuk ka diskutime, po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shpalljen e titullit 'Qytetar Nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026', U votua me unanimitet nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me unanimitet të votave e aprovuan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026'.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi post mortem', i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi post mortem', i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026', me qenë se nuk ka diskutime po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi post mortem', i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026'.
U votua me unanimitet nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me unanimitet të votave e aprovuan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi post mortem', i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimin për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi post mortem', i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026'.

Pika e shtatë (7) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për taksa komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim të dytë tani katër rregullore nga pika e shtatë deri në pikën e dhjetë, po e zhvillojmë diskutimin së bashku, ndërsa votimin e bëjmë ndaraz, nëse jeni dakort.

Rrahim Sogojeva: Pas analizimit të këtyre katër rregulloreve nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, ne pajtohemi për aprovimin e tyre dhe procedimin për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Laureat Gojnovci: Këto katër rregullore nuk janë shqyrtuar si duhet deri tani, ka patur nevojë për takime shtesë, te rregullorja për taksa komunale, vetë Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik ka patur një përplasje me anëtarë të Grupit Punues dhe e ka ndërprerë në mënyrë arbitrare takimin e punës, ju e dini qasjen nga e kaluara, ku vetë Nënkryetari i Komunës z. Shpend Bardiqi, i ka quajtur Drejtorët e Komunës 'rjepsa' dhe nuk ka patur një qasje të tillë, sikur ka ndodh në atë takim të punës. Rregulloren e hapësirave publike e keni marrë nga Komuna e Mitrovicës së Veriut, është e njëjtë, nuk është analizuar situate jonë, nuk është plotësuar me nene tjera të nevojshme, te rregullorja e subvencioneve, mungojnë kriteret për përfituesit e subvencioneve, është dashur ta merrni modelin e Komunës së Pudujevës, kjo qasje nga ana e juaj nuk është e mirë, duhet të reflektoni, t'i përgadisim mirë këto rregullore me konsenzus dhe t'i aprovojmë së bashku në

mënyrë unanime, sepse janë në të mirën e qytetarëve, jo të vendosim taksa komunale në mënyrë arbitrare, pa kurfarë analizë paraprake.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për rregulloren e shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve në hapësira publike, kemi diskutar gjatë më qytetarë, është pranuar ndryshimi te neni 16, do të jetë sipas tavolinave të vendosura në hapësira publike..

Drejtori për Arsim: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tek rregullorja për ndarjen e subvencioneve, e kemi mbajtur takimin me anëtarët e Grupit Punues, tani janë të vendosura kriteret për përfituesit e subvencioneve në arsim dhe fusha tjera.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve e qesim në votim për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës të 'Projekt-Rregullores për taksa komunale'

U votua me: tre vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim në shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregulloren për taksa komunale', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e dytë të 'Projekt-Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

Pika e tetë (8) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës të 'Projekt-Rregulloren për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike'

U votua me: tre vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim në shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e dytë të 'Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike'

Pika e nëntë (9) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës: Tani po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës të 'Projekt-Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës'

U votua me: tre vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim në shqyrtimin e

dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e dytë të 'Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës'.

Pika e dhjetë (10) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për organizmin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e qesim në votim për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës të 'Projekt-Rregulloren për organizmin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'

U votua me: tre vota 'për', një votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim në shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullores për organizmin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e dytë të 'Projekt-Rregullores për organizmin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Propozim për shqyrtim dhe dhëniën e ndihmës financiare për shërim shëndetësorë për palën Safet Selimi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi propozimin që ka ardhë nga Partia Demokratike e Kosovës, znj. Dardane Sogojeva, ku kërkohet ndihmë financiare për shërim për palën Safet Selimi, propozojë qe ne të marrim një vendim që te delegojmë këtë kompetencë, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe komisionit që është marrë me vlerësimin e problemeve shëndetësore, sepse Kuvendi Komunal duhet t'i rregulloj këto punë një herë e mirë. Tani e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Për shqyrtimin urgjent të kërkesës së palës Safet Selimi, për ndihmë financiare për shërim të mëtutjeshëm në një Komisionin urgjent të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me unanimitet nga anëtarët të pranishmit në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa, me unanimitet të votave e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Kërkesën për ndihmë financiare për shërim të palës z. Safet Selimi', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin urgjent të kërkesës së palës z. Safet Selimi, për ndihmë financiare për shërim në Komisionin urgjent të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për plotësimin e vendimit në përfshirjen e Drejtorit të Inspektoriatit të Komunës së Fushë Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi propozimin për përfshirjen e Drejtorit të Inspektoratit z. Durim Hajra, në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, me qenë se nuk ka diskutime po e qesim në votim.

U votua me unanimitet nga anëtarët të pranishmit në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa, me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për plotësimin e vendimit në përfshirjen e Drejtorit të Inspektoriatit të Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimin për plotësimin e vendimit në përfshirjen e Drejtorit të Inspektoriatit të Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2025-2029'.

Pika e trembëdhjetë (13) - Të ndryshme.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A keni dikush për të shtruar ndonjë çështje për diskutim.
Nëse jo atëherë falëminderit shumë, shihemi në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje.
Mbledhja përfundoi në ora 11:35 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani